VENDIM
Nr.708, datë 18.10.2006

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR, 2004

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve e marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar, 2004, për projektin "Shërbimi i studimit dhe i ekspertëve, VI", me një fond grant 1 200 000 (një milion e dyqind mijë) euro.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR, 2004

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë:

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje, me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare të datës 2 dhjetor 2004 në Tiranë,

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë u jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe/ose marrësve të tjerë që do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau, Frankfurt mbi Majn, një shumë financimi me vlerë prej gjithsej 1 200 000,-- EUR (me fjalë: një milion e dyqind mijë euro) për krijimin e "Fondit të studimeve dhe të specialistëve VI".

U konstatua se projekti vlen për t'u mbështetur.

2. Po të merren vesh Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

Në qoftë se projekti i përmendur në paragrafin 1 do të zëvendësohet me një projekt, i cili plotëson kushtet e posaçme për mbështetjen nëpërmjet një shume financimi, si projekt i mbrojtjes së mjedisit ose të infrastrukturës sociale, ose si fond garantues të kredive për ndërmarrje të mesme, ose si masë, e cila i shërben përmirësimit të pozitës shoqërore të grave, ose si masë, e cila synon luftimin e varfërisë, duke u mbështetur në parimin e vetëndihmës, atëherë mund të jepet një shumë financimi, përndryshe mund të jepet një hua.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratën që do të përfundohet midis Kraditanstalt für Wideraufbau dhe marrësit të shumës së financimit, kontratë e cila u nënshtrohet dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1 do të zhvleftësohet në rast se kontratat përkatëse për financim nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumën në fjalë, ky afat mbaron më datë 31 dhjetor 2012.

2. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrësi i shumës së

financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Widereaufbau pretendime eventuale lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratës për financim, e cila do të përfundohet sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontatës së përmendur në nenin 2.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezulton nga dhënia e shumës së financimit, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë më datën 12.9.2006 në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.